

# **S T A T U T**

## **i Klubit të Motoristëve SHQIPONJAT**

### **1. Emri, selia dhe qëllimi**

- Neni 1** Me emrin «Klubi i Motoristëve SHQIPONJAT» krijohet kjo shoqatë sipas Nenit 60 e në vijim të Kodit Civil Zviceran (ZGB).
- Neni 2** Selia e shoqatës është në vendbanimin e presidentit respektiv.
- Neni 3** Shoqata është neutrale nga këndvështrimi politik dhe fetar.
- Neni 4** Shoqata është një bashkim motoristësh shqiptarë, amatorësh nga Zvicra dhe jashtë saj. Shoqata mund të blejë ose të marrë me qira një lokal dhe ta administrojë atë.

### **2. Anëtarësimi**

- Neni 5** Shoqata përbëhet nga:
- Anëtarët aktivë
  - Veteranët
  - Anëtarët e lirë
  - Anëtarët e nderit
  - Anëtarët pasivë

**Anëtarë aktivë** mund të bëhen persona madhorë me karakter të mirë dhe njerëz me prirje për sportet me motor. Ata duhet të zotërojnë një motor të regjistruar me minimumi 125 ccm dhe një leje drejtimi të vlefshme.

**Veteran** bëhet kush ka hyrë si anëtar aktiv në shoqatë dhe ka qenë pjesë e saj për 15 vjet. Emërimi bëhet nëpërmjet dorëzimit të një certifikate. Veteranët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si anëtarët aktivë (duke mbajtur parasysh ndryshimet në Nenin 13).

**Anëtar i lirë** bëhet kush ka hyrë si anëtar aktiv në shoqatë dhe ka qenë për 25 vjet anëtar i saj. Emërimi bëhet nëpërmjet dorëzimit të një certifikate. Anëtarët e lirë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si anëtarët aktivë (duke mbajtur parasysh ndryshimet në Nenin 13).

**Anëtar nderi** bëhet ai që ka merita të veçanta për sportin me motor ose për Klubin e Motoristëve SHQIPONJAT. Anëtarët e nderit mund të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Kryesisë. Emërimi bëhet nëpërmjet dorëzimit të një certificate. Anëtarët e nderit kanë të drejtë vote, për sa kohë që më parë kanë qenë anëtarë aktivë, veteranë apo anëtarë të lirë.

Si **anëtarë pasivë** mund të pranohen persona fizikë ose juridikë. Ata nuk kanë të drejtë vote.

## Neni 6

### **Pranimi, largimi dhe përjashtimi**

**Pranimi** bëhet nga kryesia në bazë të një deklaratë anëtarësimi me shkrim. Me hyrjen në shoqatë, anëtari i pranuar shprehet dakord me statutin dhe vendimet e Shoqatës. Çdo anëtari i jepet një kopje e statutit. Askush nuk mund të ngrejë pretendimin për t'u pranuar, pranimi mund të refuzohet pa dhënë arsytet. Në këtë rast personi që ka bërë kërkesën mund t'i drejtohet me rekurs të arsyetuar me shkrim Asamblesë së Përgjithshme, e cila pas kësaj merr vendimin përfundimtar.

Anëtarësimi përfundon me vdekjen, largimin ose përjashtimin e anëtarit. **Largimi** mund të bëhet vetëm në fund të vitit të Shoqatës dhe duke respektuar një afat prej 30 ditësh.

Një anëtar, i cili vepron në kundërshtim me interesat e Shoqatës, mund të përjashtohet nga Shoqata. **Përjashtimi** bëhet nga Kryesia dhe i bëhet me dije me shkrim anëtarit, duke i dhënë edhe arsytet. Në këtë rast personi i përjashtuar mund t'i drejtohet me një rekurs të arsyetuar me shkrim Asamblesë së Përgjithshme, e cila pas kësaj merr vendimin përfundimtar. Anëtarët që janë larguar apo janë përjashtuar nga Shoqata nuk kanë asnjë të drejtë mbi kapitalin e Shoqatës. Largimi apo përjashtimi nuk të çlirojnë nga detyrimi për të paguar kontributet e prapambetura dhe aktuale të Shoqatës apo detyrime të tjera financiare kundrejt Shoqatës.

### 3. Organizimi

#### Neni 7

Organet e Shoqatës janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme
- b) Kryesia
- c) Zyra e Kontrollit

#### Neni 8

Organi më i lartë i Shoqatës është Asambleja e Përgjithshme. Ajo mbledhet rregullisht çdo vit në tremujorin e parë të vitit.

Thirrja e Asamblesë quhet e rregullt, nëse nga Kryesia përcaktohet koha, vendi dhe rendi i ditës dhe këto u bëhen me dije anëtarëve të paktën 1 muaj përpara.

#### Neni 9 (Asambleja e Përgjithshme)

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme:

1. Zgjedhja e numëruesve të votave
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Asamblesë së Përgjithshme
3. Miratimi i raporteve vjetore
4. Shkarkimi nga përgjegjësia (miratimi i veprimtarisë)
5. Miratimi i llogarive vjetore dhe i raportit të Zyrës së Kontrollit
6. Caktimi i kontributeve vjetore
7. Caktimi i kompensimeve të çdo lloji (Kryesia, delegacionet, funksionarë të tjerë)
8. Miratimi i planit buxhetor (buxheti)
9. Zgjedhja e
  - Presidentit
  - Zëvendëspresidentit
  - Arkëtarit
  - Sekretarit
  - Pjesës tjetër të Kryesisë
  - Zyrës së kontrollit.
10. Miratimi i programit vjetor
11. Emërimi i anëtarëve të nderit
12. Marrja e vendimeve për kërkesa të kryesisë dhe të anëtarëve
13. Përrjashtimi i anëtarëve që kanë bërë rekurs
14. Rishikimi i statuteve
15. Vendimi për shpërbërjen e Shoqatës

Kërkesat për Asamblenë e Përgjithshme i duhen paraqitur me shkrim Presidentit jo më vonë se 14 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme e thirrur në mënyrë të rregullt është e aftë të marrë vendime pavarësisht numrit të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.

Shpërbërja dhe likuidimi i Shoqatës mund të vendoset vetëm nga Asambleja e Përgjithshme. Për këtë duhet të jenë të pranishëm 3/4 e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote, por për marrjen e vendimeve duhet shumicë të cilësuar me 3/4.

Të gjitha vendimet e tjera të shoqatës merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve me të drejtë vote që janë të pranishëm. Në rast se ka numër të barabartë votash, vendimi merret në bazë të votës së Kryetarit. Zgjedhjet dhe votimet bëhen të hapura, për sa kohë që nuk nevojitet procedurë e fshehtë.

Asambleja Kryesore mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme sa herë që e vlerëson për të nevojshme Kryesia ose nëse këtë gjë e arsyeton dhe kërkon me shkrim 1/5 e anëtarëve me të drejtë vote.

## **Neni 10 (Kryesia)**

Kryesia përbëhet nga

- Presidenti
- Zëvendëspresidenti
- Financieri
- Sekretari
- Jo më shumë se 9-11 anëtarë të tjerë

Anëtarët e Kryesisë zgjidhen për katër vjet dhe mund të rizgjidhen edhe për një mandat tjetër. Anëtarët e kryesisë zgjidhen individualisht.

Kryesia merret me ato çështje, të cilat nuk i janë caktuar shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme. Kryesia është e aftë të marrë vendime, nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të saj.

Presidenti ose në mungesë të tij Zëvendëspresidenti ka të drejtë nënshkrimi kolektiv të detyrueshëm për Shoqatën së bashku me sekretarin ose financierin. Për korrespondencën dhe pagesat e zakonshme mjafton firma individuale e anëtarëve të Kryesisë.

Për korrespondencën në lidhje me pagesat financieri ka të drejtë firme individuale.

Anëtarët e Kryesisë nuk çlirohen nga detyrimi për të paguar kontributin e rregullt vjetor.

Presidenti ose në mungesë të tij Zëvendëspresidenti e thërret Kryesinë sa herë që kjo gjë është e nevojshme për punët e Kryesisë.

#### **Neni 11 (Zyra e kontrollit)**

Zyra e Kontrollit përbëhet nga tre persona, të cilët zgjidhen çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme. Llogaria duhet të verifikohet nga jo më pak se dy revizorë/revizore.

Nuk është e mundur rizgjedhja për vitin pasues. Revizorët financiarë nuk duhet të jenë pjesë e Kryesisë.

Zyra e kontrollit raporton dhe bën kërkesa para Asamblesë së Përgjithshme. Ajo ka të drejtë që në çdo kohë, gjithmonë e përbërë nga dy vetë, të bëjë kontrole rastësore, duke i njoftuar më parë në mënyrë të përshtatshme.

## **4. Financat**

#### **Neni 12**

Të ardhurat e Shoqatës përbëhen nga:

1. Kontributet e anëtarëve
2. Fitimet nga kapitali i Shoqatës
3. Dhurimet vullnetare
4. Të ardhurat nga aktivitete etj.

Anëtarët aktivë, veteranët dhe anëtarët pasivë paguajnë në arkë çdo vit kontributin e anëtarit, vlera e të cilit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Kontributi paguhet edhe vitin e anëtarësimit në shoqatë.

Anëtari që del nga Shoqata është i detyruar të paguajë kontributin e plotë vjetor për vitin aktual.

Viti financiar përkon me vitin kalendarik.

#### **Neni 13**

Garanci për detyrimet e Shoqatës është vetëm kapitali i Shoqatës.

Përfshihet çdo garanci personale e anëtarëve.

Kontributi i anëtarëve i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme për anëtarët aktivë nuk duhet të jetë më pak se 100,00 franga dhe më shumë se 500,00 franga.

Veteranët dhe anëtarët pasivë paguajnë gjysmën e kontributit të anëtarëve aktivë.

Anëtarët e lirë dhe anëtarët e nderit janë të çliruar nga detyrimi për të paguar kontribut anëtarësh.

## **5. Shënime përmbyllëse**

### **Neni 14**

Në rast shpërbërjeje të Shoqatës, me kapitalin e mbetur ose krijohet një fond për të vazhduar përmbushjen e qëllimeve të përmendura në Nenit 4 të Statutit, ose kapitali i jepet një fondacioni të së drejtës publike ose private me qëllim të njëjtë ose të ngjashëm. Vendimin për këtë e merr Asambleja e Përgjithshme sipas Nenit 9. Anëtarët nuk kanë asnjë të drejtë mbi kapitalin e Shoqatës.

### **Neni 15**

Ky statut u pranua nga Asambleja e Përgjithshme e datës 30 mars 2019 dhe hyn në fuqi menjëherë. Ai zëvendëson të gjitha statutet e mëparshme dhe bën të pavlefshme të gjitha vendimet e asamblesë, të cilat bien në kundërshtim me të.

Vendi dhe data:

Bern, 20.08.2019

## **Klubi i Motoristëve SHQIPONJAT**

President:

Safet Baftijaj

President nderi/Sekretar:

Salji Vejseli